



Ftesë për aplikantë: Sesion trajnimi Zhvillimi i strategjisë për lobim dhe avokim për interesat e minoriteteve në Kosovë

Brezovicë, hotel Molika, 3 – 6 Maj, 2008

Të nderuar,

Me kënaqësi ju ftojme të merrni pjesë në sesionin e dytë dhe tretë të trajnimeve në temën: **Zhvillimi i strategjisë për lobim dhe avokim për interesat e minoriteteve në Kosovë** e cila do të mbahet në Brezovicë në hotelin Molika me datat 03 – 06 maj 2008.

Moduli i parë i trajnimeve (3 – 4 maj 2008) do të fokusohet në teknikat e lobimit dhe avokimit, kurse moduli i dytë (5 – 6 maj, 2008) do të trajtojë çështjen e përgatitjes së strategjive për lobim dhe avokim në emër të minoriteteve.

Sesionet e trajnimeve që janë duke u organizuar janë pjesë e projektit **Lobim dhe avokim për shoqëri të ardhshme multietnike dhe të qëndrueshme në Kosovë**.

Ky projekt ka për qëllim që t'i aftësojë të rinjtë që jetojnë në Kosovë që të përdorin teknika avokimi dhe lobimi për të ndikuar në përmirësimin e marrëdhënieve multietnike të përgjithshme në Kosovë.

Si pjesë e të njëjtit projekt, është mbajtur sesioni i parë i trajnimit me temën: **Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave qytetare dhe të minoriteteve në Kosovë** me datë 4 – 6 prill 2008.

Akomodimi, ushqimi dhe materialet punuese do të sigurohen nga organizatorët.

Do të mbulohen vetëm 80 % e shpenzimeve të udhëtimit.

Luteni që të dërgoni formën e plotë të aplikimit jo më vonë se me datë **28 prill 2008 (e hënë)** në këtë email adresë: office@ydprogramme.org.

Formën e aplikimit mund ta shkarkoni nga webfaqja jonë: www.ydprogramme.org

Projekti është duke u implementuar nga këto organizata: Media Pulse Leposavic, ELSA Mitrovicë, Zenit – Prizren, Konak – Rahovec dhe Programi i të rinjve për dialog - Novi Sad

Ky projekt është mbështetur nga Freedom House, me fondet e ndara nga USAID.



This project is supported by the *Kosovo Community Reconciliation Program*, sponsored by Freedom House, with funds provided by the U.S. Agency for International Development. Implemented and organized by: the Youth Dialogue Program, ELSA/Media Pulse Leposavic, Zenit Prizren, Konak Strpce.